R E P U B L I K A E SH Q I P Ë R I S Ë

**BASHKIA HIMARË**

**DREJTORIA E ÇËSHTJEVE SOCIALE, ARSIMIT DHE RINISË**

Nr.5487 prot. Himarë, më 17.07.2025

**Lënda:** Dërgohet për miratim projektvendimi "Plani Social Vendor 2025--2028 të Bashkisë Himarë"

**KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË**

Po ju dërgojmë për miratim projektvendimin "Plani Social Vendor 2025–2028 të Bashkisë Himarë"

Bashkëngjitur projektvendimi dhe relacioni sqarues për këtë projektvendim.

Ju faleminderit për bashkëpunimin!

**KRYETARI I BASHKISË**

**Vangjel Tavo**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA HIMARË

Adresa: Rr. "25 Marsi", Nr. 2, Spile, Himarë Web: www.himara.gov.al, E-mail: info@himara.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA HIMARË**
**KRYETARI**

Nr.5487/1 prot. Himarë, më 17.07.2025

**PROJEKTVENDIM**

**NR.37 DATË 17.07.2025**

**"PËR**
**MIRATIMIN E PLANIT SOCIAL VENDOR 2025–2028 TË BASHKISË HIMARË"**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2; nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b"; nenit 24; nenit 54, shkronja "k"; dhe nenit 55, pikat 2 dhe 6 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar; të ligjit nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë"; dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 505, datë 13.09.2017 "Për hartimin, miratimin, monitorimin dhe vlerësimin e planeve sociale vendore", me propozim të Kryetarit të Bashkisë Himarë:

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Plani Social Vendor i Bashkisë Himarë për periudhën 2025–2028, i hartuar në përputhje me Udhëzuesin Kombëtar për Planifikimin Social Vendor dhe procesin gjithëpërfshirës të konsultimit me aktorët lokalë. Dokumenti është bashkëlidhur këtij projektvendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Efektet financiare për zbatimin e Planit Social Vendor do të përballohen nga buxheti vjetor i Bashkisë Himarë, fondet e dedikuara nga buxheti i shtetit, si dhe nga burime të tjera vendore, kombëtare dhe donatorë ndërkombëtarë, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.
3. Ngarkohen Drejtoria e Çështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë, Drejtoria e Financës dhe e Planifikimit të Buxhetit për ndjekjen, monitorimin dhe zbatimin e Planit Social Vendor sipas objektivave dhe afateve të parashikuara në të.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

**KRYETARI I BASHKISË**

**Vangjel Tavo**

DREJTORI

Aida Halilaj

DREJTORIA JURIDIKE

Ardit Muhametaj

-REPUBLIKA E SHQIPËRISË- BASHKIA HIMARË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA HIMARË**
**DREJTORIA E ÇËSHTJEVE SOCIALE, ARSIMIT DHE RINISË**

Nr.5487/2 prot. Himarë, më 17.07.2025

## RELACION SQARUES

**Lënda:** "Për miratimin e Planit Social Vendor 2025–2028 të Bashkisë Himarë"

## KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË

Nisur nga nevojat në rritje për përmirësimin dhe strukturimin e shërbimeve sociale në nivel vendor, Bashkia Himarë ka ndërmarrë procesin e hartimit të Planit Social Vendor për periudhën 2025–2028, si një dokument strategjik dhe orientues për ndërhyrjet në fushën e mirëqenies sociale.

Ky plan është hartuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 121/2016, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 505, datë 13.09.2017, që përcakton metodologjinë për hartimin dhe zbatimin e planeve sociale nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Hartimi i këtij plani është realizuar në mënyrë gjithëpërfshirëse, përmes mbledhjes së të dhënave sociale, analizës së nevojave të komunitetit, takimeve me aktorë lokalë dhe konsultimeve me individët në nevoojë që ndodhn në territorin e bashkisë. Plani synon:

- Të identifikojë sfidat sociale që prekin grupet më vulnerabël të popullsisë;
- Të planifikojë në mënyrë të qartë dhe të matshme shërbime që përmirësojnë jetën e qytetarëve;

- Të garantojë barazi në aksesin ndaj shërbimeve sociale për të gjithë, veçanërisht për fëmijët, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuar, viktimat e dhunës në familje, përdoruesit e substancave, komunitetin LGBTIQ+, gratë në situatë të vështirë ekonomike, dhe të rinjtë në rrezik social.

Ky dokument përfshin objektiva afatmesme, masa konkrete për ndërhyrje, partneritete ndërinstitucionale dhe përllogaritje të nevojave financiare në përputhje me kapacitetet dhe mundësitë e bashkisë.
Plani ka gjithashtu në fokus zhvillimin e shërbimeve të reja, forcimin e kapaciteteve vendore, monitorimin dhe vlerësimin e impaktit social, si dhe rritjen e bashkëpunimit me donatorë dhe projekte të huaja. Miratimi i këtij dokumenti është thelbësor për të orientuar politikat sociale të Bashkisë Himarë dhe për të siguruar një sistem të drejtë, efektiv dhe gjithëpërfshirës të kujdesit shoqëror.

Për sa u parashtrua më sipër dhe në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", kërkojmë miratimin e Planit Social Vendor 2025–2028 nga ana e Këshillit Bashkiak.

Faleminderit për mirëkuptimin!

**KRYETARI I BASHKISË**

**Vangjel Tavo**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA HIMARË -

DREJTORI

Aida Halilaj

DREJTORIA JURIDIKE

Ardit Muhametaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA HIMARË**
**DREJTORIA E ÇËSHTJEVE SOCIALE, ARSIMIT DHE RINISË**

Nr.5487/3 Prot.                                                    Himarë, më 17.07.2025

**Drejtoria e Çështjeve Sociale, Arsimit Dhe Rinisë**

**Plani Social Vendor**
**2025-2028**

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE ........ 3

I.MISIONI, VIZIONI, VLERAT DHE PARIMET UDHËRRËFYESE ........ 4

1.Vizioni ........ 4
2.Misioni ........ 4
3.Parimet e Planit Social Vendor ........ Error! Bookmark not defined.

II. ANALIZA E SITUATËS ........ 5

Kuadri strategjik ........ 5
Nevojat, shërbimet e ofruara dhe boshllëqet ........ 5
Vlerësimi i nivelit aktual të shërbimeve ........ 19
Vlerësimi i Burimeve Njerëzore të Bashkisë Himarë ........ 20
Analiza e mjedisit të jashtëm dhe pikat e forta dhe dobëta ........ 22

III. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT ........ 23

IV. PLANI I VEPRIMIT ........ 25

V. MONITORIMI DHE VLERËSIMI ........ 1

Funded by
the European Union

Ky Plan Social Vendor është hartuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e saj është përgjegjësi vetëm e autorëve të tij dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.
Ky Plan Social Vendor publikohet nëpërmjet Asistencës Teknike "Mbështetjes së Bashkimit Evropian për Përfshirjen Sociale në Shqipëri" (EU4SI), të dhënë nga Bashkimi Evropian për Bashkinë e Rrogozhinë, zbatuar nga GOPA Ëorldëide Consultants.

**HYRJE**

Bashkia Himarë ndodhet në pjesën jugperëndimore të Shqipërisë, në bregdetin e Jonit, dhe bën pjesë në qarkun Vlorë. Ajo shtrihet në një sipërfaqe prej rreth 571 km² dhe përbëhet nga tre njësi administrative: Himarë, Lukovë dhe Horë-Vranisht. Sipas Censusit 2023, bashkia ka një popullsi prej 8,328 banorësh, me një përbërje të larmishme etnike dhe një strukturë demografike të karakterizuar nga një përqindje e lartë e të moshuarve (29.9% mbi 65 vjeç). Ky realitet demografik, i kombinuar me tendencat e migracionit dhe sfidat ekonomike të zonave rurale, krijon një kontekst kompleks për planifikimin e shërbimeve sociale dhe fuqizimin e komunitetit.

Plani Social Vendor i Bashkisë Himarë 2025–2028 është një dokument strategjik që reflekton angazhimin e bashkisë për të ndërtuar një sistem mbrojtës social më të fortë, më gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm. Në thelb të këtij plani qëndron vizioni për të siguruar që çdo qytetar, veçanërisht ata në situatë vulnerabël, të ketë akses të barabartë në shërbime sociale cilësore dhe mbështetje për të jetuar me dinjitet.

Ky plan mbulon periudhën 2025–2028, duke marrë parasysh se ndodhemi në mes të vitit 2025 dhe nevojën për të vendosur një bazë të fortë për planifikime të ardhshme trevjeçare. Kjo qasje do të mundësojë që nga viti 2028 e në vijim, planet sociale të bashkisë të hartohen në cikle të rregullta trevjeçare, duke garantuar koherencë me ciklet buxhetore dhe strategjitë e zhvillimit vendor.

Dokumenti bazohet në një analizë gjithëpërfshirëse të situatës sociale në territorin e Bashkisë Himarë, duke reflektuar të dhëna nga Censusi 2023, regjistri civil dhe proceset konsultative me grupet e interesit dhe komunitetin lokal. Ai evidenton sfida të rëndësishme si plakja e popullsisë, emigracioni i të rinjve dhe mungesa e shërbimeve të strukturuara për grupet vulnerabël. Në të njëjtën kohë, plani shfaq potencialet për të ndërtuar një rrjet mbështetës që bazohet në bashkëpunim ndërsektorial, fuqizimin e komunitetit dhe mobilizimin e burimeve vendore dhe partnere.

Hartimi i këtij dokumenti ka qenë një proces i hapur dhe gjithëpërfshirës, ku janë angazhuar institucione vendore, organizata joqeveritare, përfaqësues të komuniteteve dhe grupet në nevojë, me synimin për të krijuar një sistem që reflekton realisht nevojat dhe prioritetet e qytetarëve.

Plani parashikon masa konkrete për të përmirësuar cilësinë e jetës dhe për të garantuar që asnjë individ të mos mbetet jashtë rrjetës së mbrojtjes sociale. Ndër ndërhyrjet kyçe përfshihen forcimi i kapaciteteve njerëzore, zhvillimi i shërbimeve të reja sociale dhe krijimi i një qendre multifunksionale për familjet dhe grupet në nevojë, duke i përshtatur ato me kontekstin lokal dhe nevojat emergjente.

Ky dokument nuk është thjesht një hartë strategjike, por një angazhim i qartë i Bashkisë Himarë për të garantuar mirëqenie dhe mundësi të barabarta për çdo qytetar. Përmes këtij plani, Bashkia Himarë vendoset në një rol udhëheqës për të forcuar sistemin e mbrojtjes sociale, duke u bërë një shembull i qasjes gjithëpërfshirëse dhe i solidaritetit në nivel vendor. Ai vendos themelet për një zhvillim social të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës, duke i hapur rrugën një bashkie më të fuqishme dhe një komuniteti më solidar.

# I.MISIONI, VIZIONI, VLERAT DHE PARIMET UDHËRRËFYESE

## 1.Vizioni

Bashkia Himarë synon të ndërtojë një sistem të fuqishëm dhe gjithëpërfshirës të mbrojtjes sociale që garanton akses të barabartë, shërbime cilësore dhe mbështetje për të gjitha kategoritë vulnerabël, duke promovuar mirëqenie, dinjitet dhe integrim social për çdo qytetar

## 2.Misioni

Të sigurojë mbrojtje sociale efektive dhe të qëndrueshme për qytetarët në nevojë, nëpërmjet zhvillimit të burimeve njerëzore, ngritjes së shërbimeve të strukturuara dhe fuqizimit të komuniteteve për të përballuar sfidat sociale në nivel lokal.

Hartimi dhe zbatimi i Planit Social Vendor të Bashkisë Himarë mbështetet në një sërë parimesh themelore që synojnë ndërtimin e një sistemi mbrojtës social të drejtë, gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm. Këto parime janë në përputhje të plotë me legjislacionin kombëtar, Strategjinë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2024–2030 dhe angazhimet ndërkombëtare të Shqipërisë në fushën e të drejtave sociale. Ato udhëheqin çdo ndërhyrje për të adresuar nevojat reale të individëve dhe komunitetit, duke vendosur në qendër dinjitetin njerëzor, barazinë, respektimin e të drejtave, bashkëpunimin ndërsektorial dhe qeverisjen e mirë.

1. Qasja me individin në qendër dhe ndërhyrja e hershme: Plani synon që çdo ndërhyrje të fokusohet tek individi, duke siguruar një qasje të personalizuar. Identifikimi i hershëm i nevojave sociale dhe ofrimi i mbështetjes së integruar janë mekanizma që parandalojnë përkeqësimin e situatave dhe rrisin efektivitetin e shërbimeve.
2. Barazia, përfshirja sociale dhe respektimi i të drejtave të njeriut: Plani garanton akses të barabartë në shërbime për të gjithë qytetarët, me një fokus të veçantë tek kategoritë në nevojë dhe grupet vulnerabël. Respektimi i dinjitetit njerëzor dhe të drejtave themelore është një gur themeli për çdo veprim.
3. Përputhshmëria me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare:Plani ndërtohet duke respektuar plotësisht legjislacionin shqiptar, Strategjinë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2024–2030 dhe konventat ndërkombëtare për të drejtat sociale dhe mbrojtjen e grupeve në nevojë, duke garantuar kështu standarde të larta dhe qëndrueshmëri.
4. Qeverisja e mirë, transparenca dhe llogaridhënia:Proceset e planifikimit dhe zbatimit bazohen në transparencë, përfshirjen e qytetarëve dhe përdorimin e mekanizmave të rregullt të monitorimit dhe vlerësimit për matjen e rezultateve dhe rritjen e përgjegjshmërisë institucionale.
5. Bashkëpunimi ndërsektorial dhe partneritetet: Zbatimi i planit kërkon bashkëpunim të ngushtë mes institucioneve publike, organizatave joqeveritare, sektorit privat dhe komunitetit. Kjo qasje siguron një rrjet mbështetës të gjerë dhe shërbime më efektive për përfituesit.
6. Zhvillimi i qëndrueshëm dhe reduktimi i varfërisë: Plani kontribuon në fuqizimin social dhe ekonomik të individëve dhe familjeve, duke adresuar varfërinë, pabarazitë dhe duke promovuar zhvillimin afatgjatë të komunitetit.
7. Mbrojtja e privatësisë dhe të dhënave personale:Administrimi i të dhënave të përfituesve kryhet me përgjegjësi të lartë dhe në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të

dhënave personale, duke garantuar respektimin e privatësisë dhe sigurinë e informacionit.

## II. ANALIZA E SITUATËS

Kuadri strategjik

Plani Social Vendor hartohet në përputhje me:

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Konventën për të Drejtat e Njeriut;
- Konventën për të Drejtat e Fëmijëve;
- Konventën e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Kartën Sociale Evropiane (e rishikuar);
- Kartën Evropiane të Autonomisë Lokale;
- Standardet e Organizatës Botërore të Shëndetit (OBSH);
- Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit;
- CEDAË

Dokumentet strategjike:

- ✓ Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim;
- ✓ Strategjia Kombëtare për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore;
- ✓ Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi;
- ✓ Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar;
- ✓ Dokumenti Politik – Reforma e Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar në Sistemin e Mbrojtjes Sociale;
- ✓ Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore;
- ✓ Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale.

Korniza e përgjithshme ligjore, mbi bazën e të cilës organizohet dhe realizohet mbrojtja, kujdesi dhe integrimi social përbëhet nga:

- Ligji nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë";
- Ligji nr.121/2016, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë";
- Ligji nr. 104/2014, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë";
- Ligji nr.10107/2009, "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë";
- Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
- Ligji nr. 8137/1996 "Për ratifikimin e Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore" (FZ 20-1996).

Dokumente vendore:

- Plani Vendor për Arsimin Parashkollor;
- Plani Vendor i Barais Gjinore.

Nevojat, shërbimet e ofruara dhe boshllëqet

I. Vlerësimi i nevojave

### 1.1 Të dhënat demografike

Analiza demografike e Bashkisë Himarë ofron një pasqyrë të qartë mbi strukturën e popullsisë dhe dinamikat kryesore që ndikojnë zhvillimin social të territorit. Këto të dhëna janë themelore për planifikimin e shërbimeve sociale dhe hartimin e politikave të përshtatura për të përballuar sfidat e plakjes, migracionit dhe diversitetit etnik

### 1.Përshkrimi i popullsisë dhe sfidat kryesore

Bashkia Himarë, me një popullsi prej 8,328 banorësh sipas Censusit 2023, paraqet një strukturë demografike të plakur dhe tendenca të theksuara migracioni. Vetëm 10.4% e popullsisë i përket grupmoshës 0–14 vjeç, ndërsa 29.9% janë mbi 65 vjeç. Kjo situatë nënvizon mungesën e brezave të rinj dhe rrit varësinë e të moshuarve nga mbështetja familjare ose publike. Migrimi i të rinjve drejt zonave urbane apo jashtë vendit përbën një sfidë shtesë për zhvillimin ekonomik dhe social të territorit.

Figura 1: Struktura e popullsisë sipas grupmoshave (Census 2023)




Burimi: Cens 2023

Figura tregon peshën dominuese të grupmoshës 15–64 vjeç dhe përqindjen e lartë të të moshuarve, duke reflektuar sfidat e plakjes demografike në territory.

### 2 Të dhënat ekzistuese dhe boshllëqet

Popullsia është e ndarë në mënyrë pothuajse të barabartë sipas gjinisë (meshkuj: 51.2%, femra: 48.8%). Struktura demografike sipas grupmoshave evidenton një peshë të madhe të të moshuarve (29.9%), duke e renditur Bashkinë Himarë ndër bashkitë më të prekura nga fenomeni i plakjes. Në nivel etnik, sipas Censusit 2023, rreth 35% e popullsisë deklaron përkatësi etnike greke, ndërsa pjesa tjetër përbëhet kryesisht nga shqiptarë dhe një numër i vogël minoritetesh të tjera. Mungesa e të dhënave të përditësuara për lëvizjet migratore dhe popullsinë rezidente reale sipas regjistrit civil mbetet një boshllëk i rëndësishëm për planifikimin e politikave sociale.

Figura 2: Përbërja etnike e popullsisë (Census 2023)




Burimi: Bashkia Himarë dhe Cens 2023
Figura pasqyron përbërjen etnike të popullsisë, duke theksuar diversitetin dhe nevojën për politika të ndjeshme ndaj kontekstit multietnik

3 Nevojat për ndërhyrje prioritare

- ✓ Hartimi i politikave për të adresuar plakjen e popullsisë dhe për të mbështetur familjet e reja.
- ✓ Nxitja e qëndrueshmërisë demografike në zonat rurale për të frenuar shpopullimin.
- ✓ Përmirësimi i sistemit të mbledhjes dhe analizës së të dhënave demografike për vendimmarrje më të informuar.

*1.2 Të dhënat nga statistikat e mirëqenies dhe shërbimeve sociale*

**1.2.1Ndihma Ekonomike për familjen në nevojë**

***Përshkrimi i grupit dhe sfidat kryesore***

Familjet në nevojë në Bashkinë Himarë përfaqësojnë një kategori vulnerabël që përballet me mungesë të ardhurash ose të ardhura të pamjaftueshme për të mbuluar nevojat bazë të jetesës. Shumë prej tyre përjetojnë situata të ndërlikuara sociale, duke përfshirë papunësinë, probleme shëndetësore, apo përfshirjen e fëmijëve në situata të rrezikut social. Në shtator 2024, numri i familjeve përfituese nga skemat e mbështetjes sociale ishte 61 familje, me gjithsej 175 anëtarë, që përfaqëson një reduktim krahasuar me shtatorin 2022 (85 familje). Ky trend mund të reflektojë ndryshime në kriteret e përfitimit, dalje të familjeve nga skema, ose përmirësim të situatës ekonomike të një pjese të tyre.

***Të dhënat ekzistuese dhe boshllëqet***

Analiza tregon një shpërndarje të pabarabartë të familjeve përfituese nga Ndihma Ekonomike në nivel njësish administrative: Horë-Vranisht ka numrin më të lartë (38 familje), ndjekur nga Lukova (12 familje) dhe Himara (11 familje). Përqendrimi i lartë në zonat rurale lidhet me mungesën e mundësive ekonomike dhe shkallën më të lartë të varfërisë në këto zona.

Figura.3 Shpërndarja e Familjeve Përfituese të Ndihmës Ekonomike sipas Njësive Administrative ( Shtator 2024)




Burimi: Bashkia Himarë

Figura pasqyron përqendrimin më të madh të familjeve përfituese në Horë-Vranisht, duke reflektuar sfidat ekonomike të zonave rurale

Struktura e familjeve sipas numrit të anëtarëve tregon se 42% e familjeve (26 familje) kanë vetëm 1 ose 2 anëtarë, një tregues i qartë i pasojave të migracionit dhe plakjes së popullsisë. Megjithatë, ky tregues nënvizon gjithashtu mundësinë për të orientuar mbështetjen sociale drejt modeleve të reja të përkujdesjes dhe fuqizimit të familjeve të vogla.

Figura 4 Struktura e Familjeve Përfituese sipas Numrit të Anëtarëve (2024)




Figura tregon peshën e konsiderueshme të familjeve të vogla, një tregues i migracionit dhe plakjes, por edhe një mundësi për politika mbështetëse të përshtatura.

Gjithashtu, përfshirja e kategorive të tjera vulnerabël në skemat e mbështetjes është minimale: vetëm 1 individ me status jetimi dhe 3 viktima të dhunës janë përfshirë. Kjo e bën të domosdoshme fuqizimin e mekanizmave të identifikimit dhe referimit të rasteve për kategori të ndryshme në nevojë, si një hap drejt ndërtimit të një sistemi më gjithëpërfshirës dhe proaktiv.

Një boshllëk i rëndësishëm mbetet mungesa e të dhënave të detajuara për arsyet socio-ekonomike që e çojnë një familje në përfitimin e ndihmës ekonomike dhe për ndikimin afatgjatë të kësaj mbështetjeje në përmirësimin e gjendjes së tyre. Po ashtu, mungojnë të dhëna për familjet në nevojë që nuk përfitojnë aktualisht nga skemat ekzistuese dhe për nevojat e tyre specifike.

Këto sfida paraqesin një mundësi për të ngritur një sistem efektiv monitorimi dhe mbikëqyrjeje, i cili jo vetëm do të përmirësonte planifikimin, por edhe do të fuqizonte rolin e bashkisë në identifikimin, mbështetjen dhe fuqizimin e familjeve vulnerabël.

*Shërbimet ekzistuese dhe mbulimi*

Aktualisht, administratorët socialë në çdo njësi administrative ofrojnë shërbime parashoqërore për familjet dhe individët në nevojë, duke siguruar një mbështetje të parë të rëndësishme për orientimin dhe adresimin e problemeve sociale. Ky rol ka qenë vendimtar në evidentimin e rasteve dhe referimin e tyre për ndihmë të mëtejshme, por mbulimi që ofron mbetet i pamjaftueshëm për të përballuar nevojat komplekse të komunitetit.

Bashkia nuk ka të dhëna për punësimin dhe formimin profesional. Ajo nuk ka detyrë të ofrojë drejtpërdrejt punësim, por ndërmjetëson me strukturat e AKPA-së për të mbështetur individët, kryesisht ata të familjeve në nevojë dhe përfituesit e Ndihmës Ekonomike, drejt punësimit apo formimit profesional nëpërmjet skemave shtetërore.

Në territorin e bashkisë, shërbimet sociale të dedikuara për familjet në nevojë ende nuk janë të ngritura, por bashkia ka shprehur angazhimin për të zhvilluar një shërbim mbështetës për këtë kategori. Kjo iniciativë përbën një hap pozitiv drejt forcimit të rrjetit lokal të mbështetjes, ndërsa hapësira për bashkëpunim me OJF-të dhe donatorët mbetet një mundësi e rëndësishme për të sjellë eksperienca dhe burime të reja në nivel vendor.

Sfidë mbetet sigurimi i qëndrueshmërisë financiare dhe forcimi i kapaciteteve njerëzore për të garantuar funksionimin e shërbimeve të reja.

*Nevojat për ndërhyrje prioritare:*

- ✓ Forcimi i sistemit të identifikimit dhe vlerësimit të nevojave reale të familjeve, për të përfshirë edhe ato që nuk përfitojnë aktualisht.
- ✓ Zgjerimi i formave të mbështetjes së familjeve përtej pagesave cash, përfshirë programe të fuqizimit ekonomik dhe shërbime sociale mbështetëse.
- ✓ Nxitja e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe partneriteteve me OJF-të dhe donatorët për zhvillimin e shërbimeve shoqëroreme fokus të veçantë në parandalimin e varfërisë dhe ndërprerjen e ciklit të saj ndër breza.
- ✓ Krijimi i databazave të përditësuara për monitorimin e gjendjes së familjeve në nevojë

Familjet në nevojë në Bashkinë Himarë përballen me sfida sociale dhe ekonomike të lidhura me mungesën e të ardhurave të qëndrueshme, papunësinë dhe kushtet e vështira të jetesës, sidomos në zonat rurale. Shpërndarja e pabarabartë territoriale dhe prania e lartë e familjeve të vogla pasqyrojnë ndikimin e migracionit dhe plakjes së popullsisë. Mungesa e të dhënave të detajuara për familjet jashtë skemave të mbështetjes dhe për efektivitetin e ndihmës ekzistuese kufizon planifikimin e qëndrueshëm. Angazhimi i bashkisë për të zhvilluar shërbime

mbështetëse dhe për të forcuar bashkëpunimin me aktorët lokalë dhe kombëtarë ofron mundësi për ndërtimin e një sistemi gjithëpërfshirës dhe efektiv mbështetjeje.

### 1.2.2 Individë me aftësi të kufizuar

*Përshkrimi i grupit dhe sfidat kryesore*

Personat me aftësi të kufizuar (PAK) në Bashkinë Himarë përbëjnë një kategori të ndjeshme që përballet me vështirësi të shumta sociale dhe ekonomike. Barrierat infrastrukturore, mungesa e aksesit në shërbime të përshtatura dhe mundësitë e kufizuara për pjesëmarrje në jetën shoqërore e ekonomike i vendosin PAK përballë rrezikut të izolimit dhe varfërisë.

Kjo kategori përballet gjithashtu me sfida që lidhen me përfshirjen e kufizuar në arsim dhe mungesën e mbështetjes së duhur për fuqizim ekonomik. Varësia e tyre nga familjarët dhe mbështetja që aktualisht konsiston kryesisht në pagesa mujore për aftësinë e kufizuar nuk janë të mjaftueshme për të garantuar një jetë të pavarur dhe dinjitoze. Situata aktuale kërkon politika gjithëpërfshirëse dhe ndërhyrje të koordinuara për të përmirësuar cilësinë e jetës së kësaj kategorie.

Situata nënvizon nevojën për një analizë të thelluar të të dhënave mbi PAK, për të ndërtuar politika të orientuara drejt nevojave reale

*Të dhënat ekzistuese dhe boshllëqet*

Në Bashkinë Himarë janë evidentuar gjithsej 207 persona me aftësi të kufizuar (PAK), të shpërndarë midis njësive administrative Lukovë (80 PAK), Himarë (64 PAK) dhe Horë-Vranisht (63 PAK). Shpërndarja territoriale tregon një përqendrim të lehtë në Lukovë, ndërsa dy njësitë e tjera paraqesin numër të ngjashëm përfituesish.

Figura 5: Shpërndarja e personave me aftësi të kufizuar sipas njësive administrative




Burimi: Bashkia Himarë

Figura tregon shpërndarjen territoriale të PAK, me përqendrim më të lartë në Lukovë, pasuar nga Himara dhe Horë-Vranisht, duke reflektuar sfidat për ofrimin e shërbimeve të barabarta në të gjithë territorin

Sipas kategorive të aftësisë së kufizuar, 20 persona janë paraplegjikë ose tetraplegjikë, 35 janë të verbër dhe 152 (73%) përfshihen në grupin "PAK të tjerë", i cili përbën shumicën dërrmuese dhe reflekton një gamë të gjerë gjendjesh që kërkojnë mbështetje të diferencuar.

Figura 6: Shpërndarja e personave me aftësi të kufizuar sipas kategorive




Burimi: Bashkia Himarë

Figura pasqyron dominimin e kategorisë "PAK të tjerë", duke theksuar nevojën për programe të diferencuara mbështetëse që adresojnë larmishmërinë e gjendjeve brenda këtij grupi. Megjithëse bashkia disponon një listë nominale të PAK, mungon një databazë e detajuar mbi nevojat specifike sociale, ekonomike dhe shëndetësore të kësaj kategorie. Ky boshllëk i informacionit pengon vlerësimin e saktë të situatës dhe kufizon planifikimin efektiv të ndërhyrjeve. Gjithashtu, nuk ka të dhëna të azhurnuara për ndryshimet në statusin shëndetësor apo përfshirjen në aktivitete sociale, duke e bërë të vështirë krijimin e një sistemi funksional monitorimi dhe referimi.

Situara nënvizon nevojën për një rishikim të shërbimeve ekzistuese dhe mbulimit të tyre

***Shërbimet ekzistuese dhe mbulimi***

Shërbimet për personat me aftësi të kufizuar (PAK) në Bashkinë Himarë janë të kufizuara dhe mbulojnë vetëm një pjesë të nevojave të kësaj kategorie. Aktualisht, shërbimi i ndihmësit personal përbën mbështetjen kryesore, ndërkohë që mungojnë struktura të tjera të dedikuara, si qendra ditore ose programe të integruara komunitare. Në nivel njësish administrative, administratorët shoqërorë ofrojnë vetëm shërbime parashoqërore për PAK, të cilat janë të pamjaftueshme për të adresuar nevojat komplekse të kësaj kategorie.

a) Shërbimi i ndihmësit personal

Nga 207 PAK të evidentuar, vetëm 66 janë përfitues të shërbimit të ndihmësit personal. Ky mbulim është më i lartë për paraplegjikët/tetraplegjikët (95%), ndërsa për kategorinë "PAK të tjerë" mbulimi është më i ulët (20%). Ky disproporcion tregon se nevojat e grupeve të ndryshme PAK nuk janë adresuar në mënyrë të barabartë.

Fig 6

| Kategoritë e PAK | Nr. PAK | PAK përfitues të Ndihmësit Personal |
|---|---|---|
| Para dhe tetraplegjikë | 20 | 19 |

| | | |
|---|---|---|
| Të verbër | 35 | 16 |
| PAK të tjerë | 152 | 31 |
| TOTALI | 207 | 66 |

Burimi: Bashkia Himarë

b) Arsim

Përfshirja e fëmijëve dhe të rinjve me AK në arsim është minimale. Aktualisht, vetëm 3 fëmijë me AK ndjekin kopshtin (të tre nga njësia administrative Himarë), ndërkohë që mungojnë të dhëna për pjesëmarrjen në arsimin 9-vjeçar dhe të mesëm. Në nivel të arsimit të lartë, vetëm 1 student me AK është i evidentuar.

c) Punesimi

Nuk ka të dhëna mbi përfshirjen e PAK në tregun e punës, nivelin e papunësisë apo pjesëmarrjen e tyre në programe të formimit profesional. Ky boshllëk informacioni e bën të vështirë hartimin e politikave për fuqizimin ekonomik të kësaj kategorie.

d) Shërbime shoqërore

Në territorin e Bashkisë Himarë mungojnë shërbime sociale të strukturuara për PAK. Aktualisht, administratorët socialë në çdo njësi administrative ofrojnë vetëm shërbime parashoqërore, të cilat nuk mjaftojnë për të garantuar përfshirjen sociale dhe mbështetjen afatgjatë të personave me AK.

Përpjekjet për të ofruar shërbimet për personat me aftësi të kufizuar duhet të orientohen drejt krijimit të një rrjeti mbështetës gjithëpërfshirës, që promovon pavarësinë, dinjitetin dhe pjesëmarrjen aktive të tyre në jetën komunitare. Kjo qasje do të mundësojë zhvillimin e politikave dhe shërbimeve që reflektojnë nevojat dhe potencialet e çdo individ

*4 Nevojat për ndërhyrje prioritare*

- ✓ Krijimi i një databaze të detajuar dhe të azhurnuar për PAK dhe nevojat e tyre.
- ✓ Zhvillimi i shërbimeve sociale për PAK dhe krijimi i formave të reja të mbështetjes për të lehtësuar jetesën e pavarur për PAK
- ✓ Mbështetje për përfshirjen e PAK në arsim dhe programe të formimit profesional.
- ✓ Nxitja e punësimit të PAK përmes bashkëpunimit ndërinstitucional dhe skemave të mbështetjes për punësim të asistuar.

Diagnoza për personat me aftësi të kufizuar në Bashkinë Himarë ofron një pasqyrë të qartë të sfidave dhe mundësive për veprim. Ajo nënvizon rëndësinë e zhvillimit të shërbimeve gjithëpërfshirëse dhe politikave të orientuara drejt fuqizimit të kësaj kategorie, duke garantuar akses të barabartë, pjesëmarrje aktive dhe jetesë dinjitoze. Angazhimi institucional dhe bashkëpunimi me aktorë lokalë dhe kombëtarë do të jenë kyç për të arritur një mbështetje të qëndrueshme dhe të integruar për personat me aftësi të kufizuar.

### 1.2.3 Fëmijë

***Përshkrimi i grupit dhe sfidat kryesore***

Fëmijët përfaqësojnë një grup shumë të rëndësishëm për zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit në Bashkinë Himarë. Pavarësisht përpjekjeve për mbrojtjen e tyre, kjo kategori përballet me sfida të shumta sociale dhe ekonomike. Një pjesë e fëmijëve jetojnë në familje me vështirësi të theksuara ekonomike, të cilat ndikojnë në aksesin e tyre në arsim, shëndetësi dhe shërbime të tjera bazë. Gjithashtu, rritja e fluksit të fëmijëve në situatë rruge gjatë sezonit turistik, kryesisht fëmijë të ardhur nga zona të tjera, përbën një sfidë shtesë për bashkinë dhe mekanizmat e saj të mbrojtjes së fëmijëve.

***Të dhënat ekzistuese dhe boshllëqet***

Sipas të dhënave administrative, në Bashkinë Himarë funksionojnë:

- 1 çerdhe me 18 fëmijë (5 nga familje në nevojë);
- 1 kopsht bashkiak dhe 10 grupe kopshti në njësitë administrative me gjithsej 128 fëmijë
- 33 nga familje në nevojë);
- 5 shkolla 9-vjeçare publike dhe 1 jo publike, me 393 nxënës gjithsej;
- 4 shkolla të mesme me 444 nxënës, ku 33% janë vajza.

Megjithatë, mungon një databazë e plotë dhe e përditësuar për fëmijët në nevojë, duke përfshirë ata në situatë rruge etj.

Në Bashkinë Himarë, një numër i konsiderueshëm fëmijësh jetojnë me të afërm (gjyshër, xhaxhallarë, dajallarë etj.) pasi prindërit janë larguar për arsye pune brenda ose jashtë vendit. Edhe pse kjo praktikë perceptohet nga prindërit si një formë kujdesi, ligjërisht përbën braktisje, pasi mungon një vendim zyrtar për transferimin e përgjegjësisë prindërore. Kjo situatë i ekspozon fëmijët ndaj rrezikut të abuzimit dhe neglizhencës dhe thekson nevojën për ndërhyrje institucionale për garantimin e të drejtave të tyre. Bashkia dhe institucionet përkatëse duhet të promovojnë mekanizmat e kujdestarisë alternative si një zgjidhje e sigurt dhe ligjore, ndërsa prindërit dhe të afërmit duhet të sensibilizohen për rreziqet dhe detyrimet ligjore që lidhen me këtë praktikë.

***Shërbimet ekzistuese dhe mbulimi***

Bashkia Himarë ka ngritur mekanizmat bazë për mbrojtjen e fëmijëve përmes emërimit të Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijës (PMF) në sektorin social. Sipas raportit Tetor-Dhjetor 2024, PMF ka menaxhuar 14 raste të fëmijëve në rrezik, nga të cilët 10 ishin raste të reja, me 12 fëmijë që kanë përjetuar dhunë psikologjike dhe 2 fëmijë në konflikt me ligjin. Grupet Teknike të Referimit (GTR) funksionojnë rregullisht dhe bashkëpunimi me aktorët lokalë, si policia dhe arsimi, vlerësohet shumë pozitiv.

Megjithatë, mungojnë shërbime sociale të strukturuara për fëmijët, si qendrat ditore, shërbimet e kujdesit në komunitet apo programet e rehabilitimit. Administratori social ofron kryesisht shërbime parashoqërore, të cilat nuk mbulojnë nevojat komplekse të fëmijëve në nevojë.

Situata bëhet më sfiduese gjatë sezonit turistik, kur rritet numri i fëmijëve në situatë rruge, duke vështirësuar punën e PMF dhe skuadrave të terrenit të ngritura nga bashkia.

*Nevojat për ndërhyrje prioritare*

- ✓ Krijimi i një databaze të detajuar për fëmijët në nevojë dhe gjendjen e tyre sociale.
- ✓ Ngritja e shërbimeve të strukturuara për fëmijët, si qendra ditore dhe programe për fëmijët në situatë rruge.
- ✓ Sigurimi i një buxheti të dedikuar për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë.
- ✓ Zhvillimi i programeve ndërgjegjësuese për prindërit dhe komunitetin për të parandaluar dhunën dhe braktisjen.
- ✓ Bashkëpunimi me OJF-të dhe aktorët rajonalë për ofrimin e shërbimeve të integruara.
- ✓ Forcimi i kapaciteteve të PMF dhe skuadrave të terrenit për menaxhimin e rasteve komplekse.
- ✓ **Shtimi i skuadrave të terrenit gjatë sezonit turistik** për të përballuar fluksin e fëmijëve në situatë rruge dhe rasteve emergjente.
- ✓ **Ndërgjegjësimi i prindërve dhe familjeve kujdestare** për rreziqet që mund t'u kanosen fëmijëve në situata kujdestarie joformale dhe për detyrimet ligjore që lidhen me mbrojtjen e fëmijëve.

Diagnoza tregon se Bashkia Himarë ka hedhur hapa të rëndësishëm në ngritjen e strukturave për mbrojtjen e fëmijëve, por sfidat e vazhdushme kërkojnë një qasje të integruar dhe investime të qëndrueshme. Ngritja e shërbimeve sociale dhe fuqizimi i mekanizmave ekzistues do të mundësonin garantimin e një mjedisi mbrojtës dhe gjithëpërfshirës për fëmijët në nevojë. Ky është një hap thelbësor drejt përmbushjes së angazhimeve të bashkisë për mbrojtjen sociale të fëmijëve dhe zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit.

### 1.2.4 Viktima të dhunës në familje

***Përshkrimi i grupit dhe sfidat kryesore***

Viktimat e dhunës në familje në Bashkinë Himarë përbëjnë një grup të cenueshëm që përballet me pasoja të rënda sociale, emocionale dhe ekonomike. Konfliktet mbi pronësinë janë ndër shkaqet më të shpeshta të dhunës, duke çuar në tensione që manifestohen përmes dhunës fizike, psikologjike dhe ekonomike. Sipas të dhënave të fundit, viktimat janë kryesisht gra (67%), të moshuar (17%) dhe fëmijë (10%), ndërsa burrat përbëjnë 7% të rasteve.

Fig 7 Shpërndarja e viktimave të dhunës sipas grupmoshës dhe ***gjinisë*** në Bashkinë Himarë




Burimi: Bashkia Himarë

Figura prezanton: gratët dhe vajza përbëjnë shumicën dërrmuese të viktimave, ndërsa të moshuarit dhe fëmijët mbeten gjithashtu kategori të prekura në mënyrë të konsiderueshme.

Mungesa e një sistemi të integruar shërbimesh për mbështetje emergjente, këshillim dhe rehabilitim rrit rrezikun e izolimit dhe rikthimit të viktimave në ciklin e dhunës. Situata kërkon politika gjithëpërfshirëse dhe ndërhyrje të koordinuara për të garantuar mbrojtjen dhe fuqizimin e këtij grupi.

*Të dhënat ekzistuese dhe boshllëqet*

Në vitin 2022 janë regjistruar 30 raste dhune që kanë përfituar urdhër mbrojtjeje, ndërsa në vitin 2024 kjo shifër është ulur në 25 raste. Ky tregues mund të sugjerojë një rënie të lehtë të rasteve të trajtuara, por gjithashtu mund të pasqyrojë edhe sfidat që lidhen me nën-raportimin e dhunës. Nga takimet e zhvilluara me komunitetin dhe administratorët shoqërorë, del qartë se shumë viktima, veçanërisht gra dhe të moshuara, hezitojnë të denoncojnë për shkak të frikës nga stigmatizimi, mungesës së besimit tek institucionet, varësisë ekonomike ose presionit social. Kjo situatë nënvizon nevojën për të krijuar një mjedis më mbështetës dhe për të fuqizuar besimin tek mekanizmat e mbrojtjes.

Bashkia Himarë ka bërë hapa të rëndësishëm drejt përmirësimit të kapaciteteve vendore, përmes emërimit të një specialisti të dedikuar për dhunën dhe aktivizimit të Grupeve Teknike të Referimit (GTR), të cilat kanë rol kyç në koordinimin e ndjekjes së rasteve. Megjithatë, ngritja e Njësisë për Vlerësimin dhe Referimin e Nevojave (NJVRN) dhe zhvillimi i një databaze të integruar për evidentimin dhe monitorimin e rasteve mbetet një domosdoshmëri për të garantuar një sistem të plotë dhe efikas.

Për më tepër, mungesa e programeve të qëndrueshme ndërgjegjësuese dhe edukative në komunitet ka ndikuar në përforcimin e normave sociale që tolerojnë dhunën dhe në hezitimin për ta raportuar atë. Organizimi i fushatave të rregullta me fokus tek gratë dhe të rinjtë, përmes shkollave dhe aktiviteteve komunitare, do të ishte një hap i rëndësishëm për të ndryshuar perceptimet dhe për të inkurajuar denoncimin.

Forcimi i mekanizmave ekzistues, së bashku me ndërhyrje të reja për të mbushur boshllëqet, do të mundësonte një sistem më të koordinuar dhe të qëndrueshëm për parandalimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës në Bashkinë Himarë.

*Shërbimet ekzistuese dhe mbulimi*

Aktualisht, shërbimet shoqërore për viktimat e dhunës në Bashkinë Himarë janë të kufizuara. Në nivel njësish administrative, administratorët shoqërorë ofrojnë vetëm shërbime parashoqërore, që nuk janë të mjaftueshme për të adresuar nevojat komplekse të këtij grupi. Mungesa e strukturave të specializuara, si qendrat emergjente dhe shërbimet psikosociale, ka detyruar bashkinë që të mbështetet tek organizatat joqeveritare që operojnë në qarkun Vlorë për strehim emergjent dhe mbështetje të menjëhershme. Për më tepër, bashkia nuk disponon një buxhet të dedikuar për të mbuluar kostot e vlerësimeve psikologjike për gjykatat apo ofrimin e ndihmës emergjente (veshje, ushqim) për viktimat. Kjo mungesë burimesh e bën reagimin institucional fragmentar dhe jo të qëndrueshëm.

Megjithëse në Bashkinë Himarë mungojnë shërbime të strukturuara për viktimat e dhunës, një hap pozitiv është fakti që bashkia parashikon në buxhetin e saj fonde të dedikuara për fuqizimin e grave, me fokus të veçantë për mbështetjen e grave viktima të dhunës. Këto fonde synojnë të lehtësojnë aksesin e grave në programe për fuqizim ekonomik dhe social, si dhe të krijojnë mundësi për rehabilitim dhe përfshirje aktive në jetën komunitare

*Nevojat për ndërhyrje prioritare*

- ✓ Ngritja dhe funksionalizimi i Njësisë për Vlerësimin dhe Referimin e Nevojave (NJVRN).
- ✓ Sigurimi i një buxheti të dedikuar për menaxhimin e rasteve të dhunës dhe mbështetjen emergjente të viktimave.
- ✓ Zhvillimi i shërbimeve të strukturuara për viktimat, përfshirë qendra emergjente dhe programe rehabilitimi.
- ✓ Forcimi i bashkëpunimit me OJF-të dhe aktorët lokalë për të ndërtuar një rrjet mbështetës.
- ✓ Krijimi i një databaze të detajuar dhe sistem monitorimi për rastet e dhunës.
- ✓ Organizimi i fushatave të vazhdueshme ndërgjegjësuese me fokus tek shkollat dhe gratë e zonës.
- ✓ Zgjerimi dhe përdorimi efektiv i fondeve të bashkisë për fuqizimin e grave viktima të dhunës.

Diagnoza pasqyron progresin e Bashkisë Himarë në ngritjen e strukturave dhe mobilizimin e burimeve për mbrojtjen e viktimave të dhunës, duke krijuar një bazë të fortë për zhvillime të mëtejshme. Përpjekjet për fuqizimin e grave, në kombinim me forcimin e mekanizmave ekzistues dhe rritjen e ndërgjegjësimit në komunitet, hapin rrugën për një sistem gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm që garanton siguri, dinjitet dhe mundësi të reja për çdo viktimë.

### 1.2.5 Të moshuar në nevojë për shërbime përkujdesi

*Përshkrimi i grupit dhe sfidat kryesore*

Plakja e popullsisë është një ndër sfidat më të mëdha demografike për Bashkinë Himarë, një tendencë që pasqyron karakteristikat e zonave rurale dhe bregdetare të Shqipërisë. Sipas Censit 2023, 34.7% e popullsisë së bashkisë është mbi 65 vjeç, një përqindje shumë më e lartë se mesatarja kombëtare. Kjo shifër konfirmohet edhe nga të dhënat e Regjistrit Civil që evidentojnë 3,347 të moshuar në një popullsi totale prej 8,328 banorësh. Ky trend i plakjes shoqërohet me sfida të shumëfishta sociale dhe ekonomike: reduktimi i fuqisë punëtore, rritja e kërkesës për shërbime shëndetësore dhe sociale, dhe rreziku i izolimit për të moshuarit që jetojnë vetëm ose pa mbështetje familjare.

Për më tepër, migrimi i të rinjve drejt qendrave urbane ose jashtë vendit ka shkaktuar një zbrazje të fshatrave dhe një përqendrim të të moshuarve në zonat rurale, duke e bërë këtë kategori edhe më vulnerabël përballë mungesës së shërbimeve bazë. Një pjesë e të moshuarve mbështeten tek ndihma ekonomike ose pensione minimale, të cilat nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar nevojat e tyre jetësore.

*Të dhënat ekzistuese dhe boshllëqet*

Të dhënat administrative tregojnë shpërndarjen e të moshuarve: Himarë (1,930), Lukovë (890) dhe Horë-Vranisht (527). Megjithatë, mungon një analizë e detajuar mbi gjendjen sociale dhe ekonomike të tyre, sidomos për ata që jetojnë vetëm, me sëmundje kronike ose pa përkrahje familjare. Aktualisht nuk ekziston një databazë për identifikimin dhe ndjekjen e rasteve të të moshuarve në nevojë, çka e bën të vështirë planifikimin dhe ofrimin e shërbimeve të përshtatura.

Kjo mungesë të dhënash të strukturuara e pengon bashkinë të hartojë politika sociale të bazuara në evidencë dhe të adresojë nevojat reale të këtij grupi gjithnjë e më të madh.

***Shërbimet ekzistuese dhe mbulimi***

Bashkia Himarë aktualisht nuk ofron shërbime të strukturuara për të moshuarit në nevojë. Mungojnë qendrat ditore, shërbimet e kujdesit në shtëpi dhe institucionet rezidenciale që mund të lehtësonin izolimin social dhe përkeqësimin e shëndetit të tyre. Administratorët socialë në njësitë administrative ofrojnë vetëm shërbime parashoqërore si orientimi dhe asistenca për dokumentacion, të cilat nuk adresojnë nevojat komplekse të kësaj kategorie. Për situata emergjente, të moshuarit mbështeten kryesisht tek rrjeti familjar ose rast pas rasti nga OJF-të që operojnë në nivel qarku, një mbështetje që është e fragmentuar dhe jo e qëndrueshme.

*Nevojat për ndërhyrje prioritare*

- ✓ Krijimi i një databaze të detajuar për të moshuarit në nevojë dhe gjendjen e tyre sociale-ekonomike.
- ✓ Ngritja e shërbimeve komunitare si qendra ditore dhe programe të kujdesit në shtëpi.
- ✓ Sigurimi i një buxheti të dedikuar për mbështetjen e të moshuarve në nevojë.
- ✓ Bashkëpunimi me OJF-të dhe sektorin privat për ofrimin e shërbimeve të specializuara.
- ✓ Trajnimi i stafit social për identifikimin dhe menaxhimin e rasteve të të moshuarve vulnerabël.
- ✓ Zhvillimi i programeve për reduktimin e izolimit social dhe përfshirjen e të moshuarve në aktivitete komunitare.

Trendi i plakjes demografike dhe mungesa e shërbimeve të strukturuara për të moshuarit në Bashkinë Himarë kërkojnë një qasje strategjike dhe të integruar. Pavarësisht sfidave, bashkia ka potencialin të ndërtojë mbi kapacitetet ekzistuese dhe bashkëpunimet me aktorët lokalë e rajonalë për të zhvilluar një rrjet shërbimesh sociale gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme. Ndërtimi i shërbimeve sociale dhe zhvillimi i mekanizmave për identifikimin dhe mbështetjen e të moshuarve në nevojë do të kontribuonte në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe sigurimin e një jetese dinjitoze për këtë kategori në rritje. Ky është një moment kyç që Bashkia Himarë, përmes planifikimit strategjik të mbrojtjes sociale, të pozicionohet si një model për adresimin e sfidave të plakjes dhe garantimin e një jetese dinjitoze për të moshuarit e saj.

### 1.2.6 Përdorues të drogës

Në Bashkinë Himarë mungojnë të dhëna të strukturuara mbi numrin dhe karakteristikat e përdoruesve të drogës, duke e bërë të vështirë identifikimin e përmasave reale të fenomenit dhe planifikimin e shërbimeve të përshtatura. Situata bëhet më sfiduese gjatë sezonit turistik, kur rritet ndjeshëm prania e përdoruesve të substancave narkotike, përfshirë edhe persona të ardhur nga zona të tjera si turistë apo punonjës sezonalë. Aktualisht, nuk ofrohen shërbime të specializuara për këtë kategori, ndërsa administratorët socialë ofrojnë vetëm shërbime parashoqërore, si informim dhe orientim drejt institucioneve.

Kjo situatë nënvizon nevojën për ngritjen e mekanizmave funksionalë si Njësia për Vlerësimin dhe Referimin e Nevojave (NJVRN), e cila do të mundësonte evidentimin dhe adresimin në kohë të rasteve. Përveç shërbimeve për përdoruesit, janë të domosdoshme edhe programe mbështetëse për familjarët, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit dhe ndërtimin e një rrjeti komunitar mbështetës që ul stigmatizimin dhe lehtëson procesin e rehabilitimit

### 1.2.7 Individë që kanë varësi nga alkooli

Bashkia Himarë nuk disponon të dhëna të detajuara mbi përdoruesit problematikë të alkoolit dhe nuk ka një databazë për ndjekjen e rasteve. Përdorimi i alkoolit bëhet një problem i shtuar gjatë sezonit turistik, kur në territorin e bashkisë shtohet ndjeshëm numri i individëve nga jashtë (turistë dhe punonjës sezonalë), duke e vështirësuar menaxhimin e rasteve problematike. Shërbimet e ofruara mbeten të kufizuara në asistencë parashoqërore nga administratorët socialë, ndërsa mungojnë struktura të specializuara për trajtim, rehabilitim dhe mbështetje psikosociale.
Kjo situatë përbën një boshllëk serioz, duke pasur parasysh ndikimin e varësisë nga alkooli në shëndetin, familjen dhe komunitetin. Ngritja dhe funksionimi i NJVRN është shumë i rëndësishëm për evidentimin dhe referimin efektiv të rasteve, ndërsa krijimi i programeve të dedikuara për përdoruesit dhe për familjarët e tyre do të ndihmonte në parandalimin dhe trajtimin më të mirë të varësisë.

### 1.2.8 Persona LGBTIQ+

Për personat LGBTIQ+ në Bashkinë Himarë mungojnë tërësisht të dhënat mbi numrin dhe nevojat e tyre, gjë që pasqyron edhe nivelin e lartë të stigmatizimit dhe mosraportimit. Nuk ekzistojnë shërbime të strukturuara për këtë kategori, dhe aktualisht administratorët socialë ofrojnë vetëm mbështetje bazike parashoqërore, si orientimi drejt institucioneve të tjera për ndihmë.

Në këtë kontekst, ngritja e NJVRN dhe zhvillimi i programeve specifike që adresojnë si nevojat e personave LGBTIQ+ ashtu edhe ato të familjarëve të tyre janë të domosdoshme për të reduktuar diskriminimin dhe për të krijuar një sistem mbrojtës gjithëpërfshirës. Një qasje e tillë do të ndihmonte në ndërtimin e një komuniteti më tolerant dhe në garantimin e të drejtave themelore për këtë kategori.

**Vlerësimi i nivelit aktual të shërbimeve**

Vlerësimi i nivelit aktual të shërbimeve sociale në Bashkinë Memaliaj synon të ofrojë një pasqyrë të qartë mbi gamën e shërbimeve të ofruara, grupet e përfitueseve, kapacitetet aktuale, si dhe boshllëqet ekzistuese në mbështetjen e grupeve vulnerabël. Kjo analizë shërben si bazë për përcaktimin e ndërhyrjeve prioritare në kuadër të zhvillimit të Planit Social Vendor.

***Përshkrimi i gjendjes aktuale dhe sfidat kryesore***

Shërbimet shoqërore në Bashkinë Himarë janë ende në një fazë zhvillimi të hershëm dhe mbështeten kryesisht në strukturat vendore ekzistuese. Administratorët shoqërorë luajnë një rol të rëndësishëm duke ofruar shërbime parashoqërore për orientimin dhe asistencën e familjeve dhe individëve në nevojë. Përveç tyre, bashkia ka hedhur hapa pozitivë me emërimin e Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijës (PMF) dhe Koordinatorit Vendor për Dhunën, të cilët kanë rol kyç në menaxhimin e rasteve të fëmijëve dhe viktimave të dhunës.

Megjithatë, këto struktura janë të kufizuara në kapacitete dhe nuk mund të mbulojnë nevojat e larta për shërbime të specializuara në komunitet. Analiza e diagnozave për kategoritë në nevojë tregon se mungesa e një rrjeti të zhvilluar shërbimesh dhe mekanizmash të integruar është një nga sfidat kryesore. Situata përkeqësohet gjatë sezonit turistik, kur fluksi i vizitorëve dhe punonjësve sezonalë rrit nevojën për ndërhyrje sociale të menjëhershme.

***Të dhënat ekzistuese dhe boshllëqet***

Aktualisht, Bashkia Himarë nuk disponon qendra komunitare, qendra ditore apo programe për kujdesin në familje dhe rezidencial. Administratorët shoqërorë ofrojnë asistencë bazike parashoqërore për orientimin e rasteve drejt institucioneve përkatëse ose OJF-ve të qarkut Vlorë. Një element pozitiv është gjithashtu prania e PMF dhe Koordinatorit të Dhunës, të cilët ndihmojnë në identifikimin dhe referimin e rasteve, si dhe në ndërtimin e një rrjeti bashkëpunimi me institucionet e tjera vendore dhe organizatat joqeveritare.

Megjithatë, mungesa e një databaze të integruar dhe e Njësisë për Vlerësimin dhe Referimin e Nevojave (NJVRN) e kufizon aftësinë e bashkisë për të monitoruar dhe ndjekur në mënyrë efektive rastet sociale. Shërbimet emergjente ofrohen rast pas rasti nga OJF-të, ndërsa vetë bashkia nuk ka një buxhet të dedikuar për situata të tilla.

***Nevojat për ndërhyrje prioritare***

- ✓ Ngritja dhe funksionalizimi i Njësisë për Vlerësimin dhe Referimin e Nevojave (NJVRN) për koordinimin e rasteve komplekse.
- ✓ Zhvillimi i shërbimeve të strukturuara sociale (qendra ditore, qendra komunitare dhe programe të kujdesit në familje) për grupet më vulnerabël.
- ✓ Sigurimi i një buxheti të dedikuar për emergjencat sociale dhe mbështetjen e rasteve të evidentuara nga administratorët shoqërorë, PMF dhe Koordinatori i Dhunës.

- ✓ Fuqizimi i rolit të PMF, Koordinatorit të Dhunës dhe administratorëve shoqërorë për të përmirësuar zinxhirin e mbrojtjes sociale.
- ✓ Zgjerimi i skuadrave të terrenit gjatë sezonit turistik për të përballuar flukset e larta të nevojave sociale.
- ✓ Krijimi i databazave të integruara për planifikimin e bazuar në evidencë dhe ndërtimin e politikave sociale të qëndrueshme.

Bashkia Himarë ka krijuar disa struktura bazë të rëndësishme, si administratorët shoqërorë, Punonjësin për Mbrojtjen e Fëmijës dhe Koordinatorin e Dhunës, të cilët përbëjnë një pikënisje për ndërtimin e një sistemi të plotë dhe gjithëpërfshirës të shërbimeve sociale. Megjithatë, për të garantuar një mbrojtje efektive për grupet më vulnerabël, kërkohen investime të qëndrueshme në infrastrukturë, burime njerëzore dhe financiare. Zhvillimi i një rrjeti të koordinuar dhe funksional do t'i japë bashkisë kapacitetin për të përmbushur më mirë përgjegjësitë e saj ligjore dhe për të siguruar një sistem mbrojtës të aksesueshëm për të gjithë.

## Vlerësimi i burimeve njerëzore të Bashkisë Himarë

### *Përshkrimi i strukturës dhe sfidat kryesore*

Burimet njerëzore të Bashkisë Himarë për mbrojtjen sociale janë të organizuara në kuadër të Drejtorisë së Çështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë. Kjo drejtori ka një rol kyç në ofrimin e shërbimeve sociale dhe koordinimin e politikave të mbrojtjes sociale në nivel vendor. Struktura përfshin: Drejtorin e Drejtorisë, Sektorin e Ndihmës Sociale dhe Strehimit, si dhe Sektorin e Mbrojtjes Sociale, Arsimit dhe Rinisë. Brenda këtyre sektorëve janë të punësuar specialistë për mbrojtjen e fëmijës, specialistë për dhunën në familje, administratorë shoqërorë, edukatorë dhe kujdestare çerdheje.

Megjithëse këto pozicione përbëjnë një bazë të rëndësishme, sfidat mbeten të shumta për shkak të mungesës së burimeve të mjaftueshme njerëzore dhe të kapaciteteve të specializuara për të përballuar nevojat komplekse të komunitetit. Njësia për Vlerësimin dhe Referimin e Nevojave (NJVRN) nuk është ngritur ende, çka kufizon ndjeshëm funksionalitetin e sistemit të mbrojtjes sociale.

### *Të dhënat ekzistuese dhe boshllëqet*

Shërbimet shoqërore dhe çshtjet social janë detyrë dhe përgjegjësi e Drejtorisë së Çështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë e cila përbëhet nga dy sector:

- ✓ Sektori i Ndihmës Sociale dhe Strehimit me përgjegjësin e sektorit dhe specialistin e shërbimit social;
- ✓ Sektori i Mbrojtjes Sociale, Arsimit dhe Rinisë me përgjegjësin e sektorit, specialistin për mbrojtjen e fëmijës, specialistin për dhunën në familje dhe specialistin për arsimin dhe rininë;Edukatorë dhe kujdestarë në institucionet parashkollore.

Figura 8. Struktura organizative e Burimeve Njerëzore Bashkia Himarë

# Struktura organizative e Burimeve Njerëzore Bashkia Himarë




Figura pasqyron ndarjen funksionale të sektorëve dhe rolit të specialistëve për ofrimin e shërbimeve sociale dhe mbështetjes komunitare

Megjithatë, boshllëqet janë evidente: mungesa e NJVRN, kapacitete të pamjaftueshme për menaxhimin e rasteve komplekse dhe mbingarkesa e stafit aktual. Nuk ka një sistem të integruar trajnimesh për përmirësimin e kompetencave profesionale, gjë që ndikon në cilësinë e shërbimeve.

***Shërbimet e ofruara dhe mbulimi***

Aktualisht, Bashkia Himarë ofron shërbime parashoqërore dhe asistencë bazike përmes administratorëve shoqërorë, specialistëve për mbrojtjen e fëmijës dhe specialistëve për dhunën në familje. Kujdestarët dhe edukatorët e institucioneve të arsimit parashkollor kontribuojnë në përkujdesjen e fëmijëve të vegjël. Megjithatë, nuk ka shërbime të specializuara si qendra komunitare, qendra ditore apo programe për kujdesin në familje.

Mungesa e NJVRN dhe e një rrjeti të koordinuar referimi kufizon mundësinë për të ofruar mbështetje efektive dhe të integruar për grupet vulnerabël.

***Nevojat për ndërhyrje prioritare***

- ✓ Ngritja dhe funksionalizimi i Njësisë për Vlerësimin dhe Referimin e Nevojave (NJVRN);
- ✓ Shtimi i stafit të specializuar për shërbimet sociale, duke përfshirë punonjës socialë, psikologë dhe kujdestarë për rastet komplekse;
- ✓ Zhvillimi i programeve të trajnimit të vazhdueshëm për stafin ekzistues;
- ✓ Krijimi i një databaze për menaxhimin dhe monitorimin e rasteve sociale;
- ✓ Riorganizimi i strukturës së brendshme për të ndarë më mirë përgjegjësitë dhe për të rritur efektivitetin;

- ✓ Sigurimi i një buxheti të dedikuar për fuqizimin e burimeve njerëzore dhe zhvillimin e kapaciteteve.

Bashkia Himarë ka ngritur një bazë të rëndësishme të burimeve njerëzore për shërbimet sociale, përfshirë administratorët shoqërorë, specialistët për mbrojtjen e fëmijës dhe për dhunën në familje, si dhe stafin e institucioneve parashkollore. Megjithatë, për të ndërtuar një sistem të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës, është e nevojshme të investohet në rritjen e kapaciteteve, shtimin e stafit të specializuar dhe zhvillimin e mekanizmave të integruar për menaxhimin e rasteve. Një qasje strategjike në fuqizimin e burimeve njerëzore do të mundësojë një përgjigje më efektive dhe gjithëpërfshirëse ndaj nevojave të komunitetit.

**Analiza e mjedisit të jashtëm dhe pikat e forta dhe dobëta :**

Analiza SWOT për Planin Social Vendor të Bashkisë Himarë ofron një pasqyrë të qartë të gjendjes aktuale, duke evidentuar pikat e forta dhe dobësitë e sistemit ekzistues të shërbimeve sociale, si dhe duke identifikuar mundësitë dhe kërcënimet që ndikojnë në zhvillimin e mëtejshëm të tij konkretisht:

**Pikat e forta :**

1. Struktura ekzistuese e burimeve njerëzore me specialistë për mbrojtjen e fëmijës, dhunën dhe administratorët shoqërorë.
2. Prania e PMF dhe Koordinatorit Vendor të Dhunës si mekanizma për menaxhimin e rasteve.
3. Partneritete ekzistuese me OJF-të në qarkun Vlorë për mbështetje emergjente të viktimave të dhunës.
4. Shtrirja e administratorëve shoqërorë në të gjitha njësitë administrative që mundëson identifikimin fillestar të rasteve sociale.
5. Përdorimi i fondeve të bashkisë për mbështetjen e rasteve emergjente dhe për fuqizimin e grave.

**Pikat e dobëta :**

1. Mungesa e shërbimeve të strukturuara sociale (qendra komunitare, ditore, rezidenciale).
2. Kapacitetet e kufizuara profesionale të stafit për menaxhimin e rasteve komplekse.
3. Nuk ekziston një databazë e integruar për monitorimin dhe referimin e rasteve sociale.
4. Buxhet i kufizuar për shërbimet sociale krahasuar me nevojat në rritje.
5. Koordinimi ndërinstitucional dhe ndërsektorial mbetet i fragmentuar dhe jo sistematik.

**Mundësitë**

1. Financimi nga partnerët ndërkombëtarë dhe organizatat joqeveritare për zhvillimin e shërbimeve sociale.
2. Fondi Social i qeverisë që mund të shfrytëzohet për të financuar projekte të synuara për grupet vulnerabël.
3. Mbështetja ligjore dhe politike nga Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale që favorizon decentralizimin.
4. Potenciali i turizmit për të gjeneruar të ardhura shtesë në buxhetin vendor për shërbimet sociale.
5. Qasja e rritur e komunitetit ndaj mediave sociale që mund të përdoret për ndërgjegjësim.

**Kërcënimet**

1. Plakja e popullsisë dhe emigrimi që rrit presionin mbi shërbimet sociale ekzistuese.
2. Fluksi i lartë i vizitorëve dhe punonjësve sezonalë gjatë verës që sjell shtim të rasteve sociale.
3. Varësia nga OJF-të për ofrimin e disa shërbimeve emergjente, për shkak të mungesës së kapaciteteve vendore.
4. Nivel i ulët ndërgjegjësimi i komunitetit për të drejtat sociale dhe detyrimet e institucioneve.
5. Stigmatizimi i kategorive vulnerabël që pengon denoncimin e rasteve dhe qasjen në mbështetje.

## III. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT

Ky seksion paraqet kuadrin strategjik të Planit Social Vendor të Bashkisë Himarë, duke e fokusuar vëmendjen tek ndërtimi i një sistemi vendor mbrojtës, gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm. Qëllimi dhe objektivat specifike të formuluara janë të bazuara në diagnozat e kryera për kategoritë në nevojë dhe në prioritetet kombëtare të mbrojtjes sociale. Ato synojnë të orientojnë ndërhyrjet e Bashkisë drejt forcimit të kapaciteteve organizative dhe profesionale, zhvillimit të shërbimeve sociale të strukturuara dhe fuqizimit të grupeve vulnerabël. Kjo qasje është projektuar për të garantuar ofrimin e shërbimeve sociale cilësore, të koordinuara dhe të orientuara drejt nevojave të komunitetit, duke promovuar mirëqenien sociale dhe barazinë në akses për të gjithë qytetarët.

**Qëllimi:** Zhvillimi i një sistemi vendor mbrojtës dhe gjithëpërfshirës që ofron shërbime sociale cilësore, të koordinuara dhe të orientuara drejt nevojave të grupeve në nevojë.

**Objektivat Specifike**

**Objektivi 1 Të rriten kapacitetet profesionale dhe organizative të stafit të shërbimeve sociale në Bashkinë Himarë, përmes trajnimeve të vazhdueshme, shtimit të pozicioneve të specializuara dhe krijimit të Njësisë për Vlerësimin dhe Referimin e Nevojave (NJVRN), si mekanizëm kyç për menaxhimin efektiv të rasteve.**

Masa 1.1 Rritja e kapaciteteve profesionale të stafit ekzistues

- ✓ Aktiviteti 1.1.1 Hartimi dhe zbatimi i programeve të trajnimit mbi menaxhimin e rasteve komplekse, përdorimin e databazave sociale, teknikat e referimit
- ✓ Aktiviteti 1.1.2 Organizimi i trajnimeve të rregullta për:i) Administratorët shoqërorë; ii)Punonjësin për Mbrojtjen e Fëmijës (PMF); iii) Koordinatorin e Dhunës
- ✓ Aktiviteti 1.1.3 Programe shkëmbimi përvojash me bashki të tjera

**Treguesit:**

- Programe trajnimi vjetore të miratuara në vit: 1 program trajnimi në vit
- Numri i trajnimeve të realizuara çdo vit: të paktën 3 trajnime.
- Përqindja e stafit të trajnuar: minimumi 90% e stafit të përfshirë.
- Numri i stafit të përfshirë në programe shkëmbimi përvojash: të paktën 3 specialistë në vit.

**Masa 1.2**: Ristrukturimi i strukturës së shërbimeve sociale në Bashkinë Himarë

- ✓ Aktiviteti 1.2.1: Vlerësimi i **strukturës ekzistuese organizative** të shërbimeve sociale për të identifikuar boshllëqet dhe nevojat për pozicione të specializuara.
- ✓ Aktiviteti 1.2.2 Hartimi i një **strukture të re organizative**, duke përcaktuar pozicionet e reja (punonjës socialë, psikologë, specialist për moshën e trete, specialist për grupet vulnerabël) dhe profilet profesionale për secilin.
- ✓ Aktiviteti 1.2.3 Rishikimi i rregullores së Drejtorisë së Çështjeve Sociale, Arsimit Dhe Rinisë
- ✓ Aktiviteti 1.2.4 Miratimi i strukturës së re dhe rregullores së rishikuar në Këshillin Bashkiak
- ✓ Aktiviteti 1.2.5 Rekrutimi i stafit për pozicionet e reja të miratuara

**Treguesit:**

- Raport i detajuar mbi vlerësimin e strukturës ekzistuese i përgatitur brenda 6 muajve të parë.
- Identifikimi i të gjitha boshllëqeve dhe nevojave për pozicione të specializuara (minimumi 2 pozicione të rekomanduara).
- Struktura e re organizative e hartuar dhe dorëzuar për shqyrtim brenda vitit të parë.
- Lista e pozicioneve të reja të propozuara: specialist për moshën e tretë, specialist për grupet vulnerabël.
- Profilet profesionale për secilin pozicion të specifikuara dhe të miratuara nga drejtoria përkatëse.
- Rregullorja e rishikuar e Drejtorisë së Çështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë e finalizuar brenda 3 muajve nga hartimi i strukturës së re.
- Vendimi i Këshillit Bashkiak për miratimin e strukturës së re dhe rregullores së rishikuar i publikuar brenda vitit të pare
- Numri i specialistëve të rinj të rekrutuar për pozicionet e reja: minimumi 2 stafe të rinj.

**Masa 1.3**: Ngritja e Njësisë për Vlerësimin dhe Referimin e Nevojave (NJVRN)

Aktivitetet

- ✓ **Aktiviteti 1.3.1 Ngritja e** NJVRN ( miratimi, perzgjedhja e stafit)
- ✓ **Aktiviteti 1.3.2 Trajnimi i stafit të NJVRN** për procedurat e vlerësimit dhe referimit, menaxhimin e rasteve dhe përdorimin e sistemeve të databazës sociale.
- ✓ **Aktiviteti 1.3.3 Hartimi i procedurave standarde të operimit (PSO)** për funksionimin e njësisë dhe procesin e menaxhimit të rasteve.
- ✓ **Aktiviteti 1.3.4 Pajisja e NJVRN me logjistikë dhe mjete pune** (zyrë, kompjuterë, automjet, pajisje për terren).

**Treguesit:**

- **NJVRN e ngritur dhe funksionale:** deri në fund të vitit të parë të planit.

- **Numri i stafit të përzgjedhur dhe trajnuar:** të paktën 3 specialistë (koordinator, punonjës social, PMF).
- **Procedurat standarde të operimit të hartuara dhe zbatuara**
- **Numri i rasteve të vlerësuara dhe referuara nga njësia:** minimumi 50 raste brenda vitit të dytë.
- Zyra e NJVRN pajiset me mobilie dhe logjistikë bazë:

    - 2 kompjuter dhe 1 printer/skaner në funksion.
    - 1 automjet në dispozicion për punë në terren.
    - Pajisjet regjistrohen në inventarin e bashkisë dhe janë në përdorim.

- **Raporti vjetor i performancës së NJVRN** i përgatitur dhe dorëzuar çdo vit.

**Objektivi 2 Të krijohen dhe të zhvillohen shërbime sociale të strukturuara dhe lëvizëse, duke siguruar akses të barabartë për familjet në nevojë, fëmijët, të moshuarit, PAK, viktimat e dhunës, përdoruesit e substancave, personat LGBTIQ+ dhe kategori të tjera vulnerabël, me shpërndarje të barabartë të shërbimeve dhe fokus tek nevojat imediate.**

**Masa 2.1 Ngritja e shërbimit lëvizës nëpërmjet krijimit të njësisë sociale lëvizëse**

**Aktivitetet:**

- ✓ Aktiviteti **2.1.1 Ngritja e shërbimit lëvizës nëpërmjet krijimit të njësisë sociale lëvizëse,** duke përfshirë, sigurimin e burimeve financiare dhe logjistikës (mjet transporti, pajisje teknologjike, materiale pune).
- ✓ Aktiviteti **2.1.2 Rekrutimi dhe trajnimi i stafit të njësisë lëvizëse** për ofrimin e shërbimeve sociale dhe emergjente në komunitet.
- ✓ Aktiviteti **2.1.3 Hartimi i protokolleve të operimit** për vizitat në terren dhe menaxhimin e rasteve në zona të thella.
- ✓ Aktiviteti 2.1.4 Hartimi dhe zbatimi i një kalendari vjetor të vizitave të njësisë sociale lëvizëse, për të garantuar mbulim të rregullt të të gjitha njësive administrative dhe akses të barabartë të grupeve vulnerabël në shërbimet sociale.
- ✓ Aktiviteti **2.1.5 Fillimi i shërbimeve në terren dhe monitorimi periodik i performancës së njësisë.**

**Treguesit:**

- Njësia sociale lëvizëse e ngritur dhe funksionale brenda vitit të dytë të planit.
- Strukturë organizative dhe plan pune i njësisë lëvizëse i finalizuar dhe miratuar.
- Pajisja e njësisë me mjet transporti dhe logjistikë të nevojshme (minimumi 1 automjet dhe pajisje teknologjike).
- Numri i stafit të rekrutuar dhe trajnuar: të paktën 4 specialistë
- Numri i protokolleve të operimit të hartuara dhe zbatuara: të paktën 3 (për reagim të shpejtë, vizita rutinë dhe menaxhim emergjencash).
- Kalendar vjetor i vizitave i hartuar dhe miratuar

- Numri i vizitave sociale në komunitet: minimumi 100 vizita gjatë vitit të tretë.
- Shërbimi i ngritur dhe funksional: 1 sherbim levizes i ngritur dhe funksional

Masa 2.2: Zhvillimi i një sistemi të integruar për ndërhyrje emergjente sociale dhe natyrore

**Aktivitete**

- ✓ **Aktiviteti 2.2.1 Hartimi dhe miratimi i një protokolli të integruar për reagim në emergjenca sociale dhe natyrore,** që përcakton rolet dhe përgjegjësitë e skuadrës sociale lëvizëse dhe institucioneve të tjera partnere.
- ✓ **Aktiviteti 2.2.2 Trajnimi i stafit të shërbimeve sociale dhe partnerëve lokalë** (Policia, Shëndetësia, OJF-të) për zbatimin e protokollit dhe menaxhimin e rasteve emergjente në kohë reale.
- ✓ **Aktiviteti 2.2.3 Krijimi i një rrjeti bashkëpunimi dhe koordinimi** mes njësive administrative, institucioneve vendore dhe OJF-ve për menaxhimin efektiv të emergjencave.

**Treguesit**

1 protokoll i integruar i hartuar dhe miratuar nga Këshilli Bashkiak

Numri i trajnimeve të realizuara për zbatimin e protokollit (target: të paktën 2 trajnime).

Numri i stafit të shërbimeve sociale dhe partnerëve lokalë të trajnuar (target: 30 pjesëmarrës).

Masa 2.3 Zhvillimi i një programi të integruar për mbështetje psikosociale për fëmijët, personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit

**Aktivitetet**

- ✓ 2.3.1 Hartimi i programit të integruar për mbështetje psikosociale, duke përcaktuar objektivat, grupet përfituese (fëmijët në rrezik, PAK, të moshuarit e izoluar) dhe metodologjinë e ndërhyrjes.
- ✓ 2.3.2 Formimi dhe trajnimi i ekipit multidisiplinar (punonjës socialë, psikologë, infermierë) për ofrimin e mbështetjes psikosociale në terren.

**Treguesit:**

- Dokumenti i programit të integruar të mbështetjes psikosociale i hartuar dhe miratuar brenda vitit të parë të zbatimit.
- Numri i specialistëve të trajnuar për ofrimin e mbështetjes psikosociale: të paktën 6 persona (punonjës socialë, psikologë, infermierë).
- Numri i sesioneve të trajnimit të realizuara: minimumi 2 trajnime në vit.

**Masa 2.4: Zhvillimi i një sistemi të integruar elektronik për identifikimin, menaxhimin dhe ndjekjen e rasteve sociale në terren**

Aktivitetet:

- ✓ 2.4.1 Projektimi dhe zhvillimi i platformës elektronike për menaxhimin dhe ndjekjen e rasteve, duke përfshirë specifikimet teknike, zhvillimin softuerik, testimin dhe përshtatjen sipas nevojave të bashkisë.
- ✓ 2.4.2 Trajnimi i stafit të njësisë lëvizëse dhe strukturave përkatëse për përdorimin efektiv të platformës dhe për mbledhjen e të dhënave në terren.
- ✓ 2.4.3 Implementimi i platformës dhe integrimi i saj me sistemet ekzistuese të shërbimeve sociale të bashkisë.

**Treguesit:**

- Platforma elektronike e zhvilluar, testuar dhe funksionale: brenda vitit të dytë të planit.
- 3 dite trajnim per perdorimin e platformes elektronike
- Numri i stafit të trajnuar për përdorimin e platformës: të paktën 10 punonjës.
- Numri i rasteve të regjistruara dhe të ndjekura në sistem çdo vit: minimumi 100 raste.
- Raporti vjetor mbi funksionimin dhe efektivitetin e platformës: i përgatitur dhe i prezantuar çdo vit.

**Masa 2.5:** Krijimi i qendrës multifunksionale omunitare për familjet dhe grupet në Nevojë

Aktivitete:

- ✓ 2.5.1 Hartimi i konceptit dhe planit të zhvillimit për Qendrën Multifunksionale Komunitare, duke përfshirë objektivat, shërbimet që do të ofrohen dhe grupet përfituese (familjet në nevojë, fëmijët, PAK, të moshuarit, viktimat e dhunës).
- ✓ 2.5.2 Identifikimi dhe sigurimi i hapësirës fizike për qendrën, përmes ristrukturimit të një objekti ekzistues ose ndërtimit të ri.
- ✓ 2.5.3 Pajisja e qendrës me infrastrukturën dhe logjistikën e nevojshme (mobilim, pajisje teknologjike, materiale edukative dhe rekreative).
- ✓ 2.5.4 Vendosja në funksion të qendrës multifunksionale dhe ofrimi i shërbimeve sociale për familjet dhe grupet në nevojë

Treguesit:

- Plani i zhvillimit dhe koncepti i qendrës i finalizuar dhe miratuar: brenda vitit të pare
- Numri i hapësirave funksionale të përcaktuara në qendër: minimumi 3 hapësira multifunksionale (p.sh., për fëmijë, hapësirë për këshillim, hapësirë për aktivitete komunitare).
- Qendra e pajisur dhe funksionale brenda periudhës së planit.
- Numri i stafit të rekrutuar dhe trajnuar për ofrimin e shërbimeve: minimumi 5 specialistë.
- Numri i familjeve dhe individëve të mbështetur në vit: minimumi 150 përfitues/vit.

**Objektivi 3 Të zhvillohen fushata të vazhdueshme ndërgjegjësuese dhe edukative për të reduktuar stigmatizimin dhe për të promovuar pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në mbrojtjen sociale**

**Masa 3.1:** Organizimi i fushatave ndërgjegjësuese për komunitetin

Aktivitetet

- ✓ 3.1.1 Hartimi i planit vjetor të fushatave ndërgjegjësuese, me temat prioritare dhe grupet target.
- ✓ 3.1.2 Organizimi i takimeve informuese në komunitet për parandalimin e dhunës dhe promovimin e respektit për diversitetin.
- ✓ 3.1.3 Realizimi i aktiviteteve komunitare dhe fushatave në terren (evente, ditë sensibilizimi, aktivitete sportive dhe kulturore me mesazhe sociale).
- ✓ 3.1.4 Përgatitja dhe shpërndarja e materialeve informuese dhe edukative (broshura, postera, spote sensibilizuese në rrjete sociale).

**Treguesit**

- Numri i fushatave të realizuara në vit: të paktën 4 fushata/vit ( një për fëmijët, një për AK, një për dhunën dhe një për moshën e tretë).
- Numri i qytetarëve të arritur nga fushatat: minimumi 400 persona në total/vit.
- Numri i aktiviteteve edukative të realizuara: të paktën 16 aktivitete/vit (4 ëorkshope, 4 aktivitete komunitare për gruan, 4 aktivitetet komunitare per fëmijët, 4 aktivitete komunitare për AK dhe moshën e tretë).
- Numri i materialeve informuese të shpërndara: minimumi 1000 njësi/vit.

Fondi i nevojshëm për realizimit të planit të veprimit 2025-2028 është 239,681,382 leke nga të cilat 25,583,882 lekë përballohet nga Bashkia me fondet e veta dhe 211,097,500 lekë nga donator ( të pa mbuluara)

| Pershkrimi | Totali | Burimi i Financimit | |
|---|---|---|---|
| | | Bashkia | Donator |
| Objektivi Specifik 1 | 11,534,866 | 10,247,366 | 1,287,500 |
| Objektivi Specifik 2 | 226,246,728 | 17,586,728 | 208,660,000 |
| Objektivi Specifik 3 | 1,899,788 | 749,788 | 1,150,000 |
| Total | 239,681,382 | 28,583,882 | 211,097,500 |

IV. PLANI I VEPRIMIT

MATRICA E PLANIT VENDOR SOCIAL BASHKIA HIMARË

Objektivi Specifik 1 Të rriten kapacitetet profesionale dhe organizative të stafit të shërbimeve sociale në Bashkinë Himarë, përmes trajnimeve të vazhdueshme, shtimit të pozicioneve të specializuara dhe krijimit të Njësisë për Vlerësimin dhe Referimin e Nevojave (NJVRN), si mekanizëm kyç për menaxhimin efektiv të rasteve.

| Objektivi | | Indikatori | Afati i zbatimit | | Buxheti dhe burimi financimit | Institucionet përgjegjëse | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Masat | Aktiviteti | | Afati i fillimit | Afati i mbarimit | | Drejtoria/Sektori/Departamenti(Udheheqes) | Institucion kontribues (nese ka) |
| Objektivi 1 Të rriten kapacitetet profesionale dhe organizative të stafit të shërbimeve sociale në Bashkinë Himarë, përmes trajnimeve të vazhdueshme, shtimit të pozicioneve të specializuara dhe krijimit të Njësisë për Vlerësimin dhe Referimin e Nevojave (NJVRN), si mekanizëm kyç për menaxhimin efektiv të rasteve. | | | | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Masa 1.1 Rritja e kapaciteteve profesionale të stafit ekzistues | Aktiviteti 1.1.1 Hartimi dhe zbatimi i programeve të trajnimit mbi menaxhimin e rasteve komplekse, përdorimin e databazave sociale, teknikat e referimit | Një program trajnimi i hartuar dhe miaturar | 2025 | 2028 | 94,788 leke në tre vite/Bashkia me fondet e veta | Drejtoria e Çështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë | OF |
| | | 3 Module te hartuara | 2025 | 2028 | 225,000 leke/Donator I pambuluar | Drejtoria e Çështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë | OF |
| | | 3 Trajnime te realizuara | 2025 | 2028 | 67500 leke/Donator I pambuluar | Drejtoria e Çështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë | OF |
| | Aktiviteti 1.1.3 Programe shkëmbimi | 3 pervoja shkembimi | 2025 | 2028 | | Drejtoria e Çështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë | OF |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | përvojash me bashki të tjera | | | | | | |
| | Aktiviteti 1.2.1: Vlerësimi i strukturës ekzistuese organizative të shërbimeve sociale për të identifikuar boshllëqet dhe nevojat për pozicione të specializuara. | Një raport vleresimi i realizuar | 2025 | 2025 | 47,394 leke/Bashkia me fondet e veta | Drejtoria e Çështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë | OF |
| | Aktiviteti 1.2.2 Hartimi i një strukture të re organizative, duke përcaktuar pozicionet e reja (punonjës socialë, psikologë, specialist për moshën e trete, specialist për grupet | Struktura e re organizative e hartuar | 2025 | 2025 | 47,394 leke/Bashkia me fondet e veta | Drejtoria e Çështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë | OF |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | vulnerabël) dhe profilet profesionale për secilin. | | | | | | |
| | Aktiviteti 1.2.3 Rishikimi i rregullores së Drejtorisë së Çështjeve Sociale, Arsimit Dhe Rinisë | Rregullorja e rishikuar dhe dorezuar per miratim ne keshillin bashkiak | 2025 | 2026 | 47,394 leke/Bashkia me fondet e veta | Drejtoria e Çështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë | OF |
| | Aktiviteti 1.2.4 Miratimi i strukturës së re dhe rregullores së rishikuar në Këshillin Bashkiak | Struktura e re organizative dhe rregullorja e miratuar ne keshillin bashkiak | 2026 | 2026 | Pa kosto | Drejtoria e Çështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë | OF |
| | Aktiviteti 1.2.5 Rekrutimi i stafit për pozicionet e reja të miratuara | Numri I personave te rekrutuar | 2026 | 2027 | Pa kosto | Drejtoria e Çështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë | OF |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Masa 1.3: Ngritja e Njësisë për Vlerësimin dhe Referimine Nevojave (NJVRN) | Aktiviteti 1.3.1 Ngritja e NJVRN ( perzgjedhja e stafit) | Numri I stafit te rekrutuar, NJVRN eshte ngritur dhe funksionale | 2026 | 2026 | 9,510,396 ALL/Bashkia me fondet e veta | Drejtoria e Çështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë | OF |
| | | 3 moduleve te hartuara | 2026 | 2026 | 225,000 ALL/Donator i pambuluar | Drejtoria e Çështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë | OF |
| | | 3 Trajnime te realizuara | 2026 | 2027 | 45,000 ALL/ Donator i pambuluar | Drejtoria e Çështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë | OF |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Aktiviteti 1.3.3 Hartimi i procedurave standarde të operimit (PSO) për funksionimin e njësisë dhe procesin e menaxhimit të rasteve | 3 protokolle/procedura standarte te operimit te hartuara | 2026 | 2028 | 225,000 ALL/Donator i pambuluar | Drejtoria e Çështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë | OF |
| | Aktiviteti 1.3.4 Pajisja e NJVRN me logjistikë dhe mjete pune (zyrë, kompjuterë, automjet, pajisje për terren). | 3 sete pune, 2 kompjuter dhe 1 printer/skaner në funksion. 1 automjet në dispozicion për punë në terren. Pajisjet regjistrohen në inventarin e bashkisë dhe janë në përdorim. | 2026 | 2027 | 500,000 Leke/Bashkia me fondet e veta 500,000 leke /Donator i pambuluar | Drejtoria e Çështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë | OF |
| | | | | | | | |
| | Totali | | | | 11,534,866 | | |

**Objektivi Specifik 2 Të krijohen dhe të zhvillohen shërbime sociale të strukturuara dhe lëvizëse, duke siguruar akses të barabartë për familjet në nevojë, fëmijët, të moshuarit, PAK, viktimat e dhunës, përdoruesit e substancave, personat LGBTIQ+ dhe kategori të tjera vulnerabël, me shpërndarje të barabartë të shërbimeve dhe fokus tek nevojat imediate.**

<table>
<tr><th colspan="2">Objektivi</th><th rowspan="2">Indikatori</th><th colspan="2">Afati i zbatimit</th><th rowspan="2">Buxheti dhe burimi financimit</th><th colspan="2">Institucionet përgjegjëse</th></tr>
<tr><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr>
<tr><td colspan="8">Objektivi specifik 2: Të krijohen dhe të zhvillohen shërbime sociale të strukturuara dhe lëvizëse, duke siguruar akses të barabartë për familjet në nevojë, fëmijët, të moshuarit, PAK, viktimat e dhunës, përdoruesit e substancave, personat LGBTIQ+ dhe kategori të tjera vulnerabël, me shpërndarje të barabartë të shërbimeve dhe fokus tek nevojat imediate.</td></tr>
<tr><td></td><td></td><td>Njësia sociale lëvizëse e ngritur dhe funksionale brenda vitit të dytë të planit,</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr>
</table>

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | teknologjike, materiale pune). | Pajisja e njësisë me mjet transporti dhe logjistikë të nevojshme (minimumi 1 automjet dhe pajisje teknologjike). | | | | | |
| | | Strukturë organizative dhe plan pune i njësisë lëvizëse i finalizuar dhe miratuar | 2026 | 2026 | Pa kosto | Drejtoria e Çështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë | OF |
| | | Numri i stafit të rekrutuar : të paktën 4 specialistë | 2026 | 2026 | Pa kosto | Drejtoria e Çështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë | OF |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Aktiviteti 2.1.3 Hartimi i protokolleve të operimit për vizitat në terren dhe menaxhimin e rasteve në zona të thella. | Numri i protokolleve të operimit të hartuara dhe zbatuara: të paktën 3 (për reagim të shpejtë, vizita rutinë dhe menaxhim emergjencash). | 2026 | 2028 | 225,000 lek/Donator I pambuluar | Drejtoria e Çështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë | OF |
| | Aktiviteti 2.1.4 Hartimi dhe zbatimi i një kalendari vjetor të vizitave të njësisë sociale lëvizëse | 3 kalendare vjetor te vizitave te njesise sociale levizese jane hartuar | 2026 | 2028 | 63,192 Lek/Bashkia me fondet e veta | Drejtoria e Çështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë | OJF |
| | Aktiviteti 2.1.5 Fillimi i shërbimeve në terren | Shërbimi i ngritur dhe funksional: 1 sherbim levizes i ngritur dhe funksional | 2026 | 2028 | 16,303,536 leke/Bashkia me fondet e veta | Drejtoria e Çështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë | OF |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Masa 2.2: Zhvillimi i një sistemi të integruar për ndërhyrje emergjente sociale dhe natyrore | Aktiviteti 2.2.1 Hartimi dhe miratimi i një protokolli të integruar për reagim në emergjenca sociale dhe natyrore, që përcakton rolet dhe përgjegjësitë e skuadrës sociale lëvizëse dhe institucioneve të tjera partnere | 1 protokoll i integruar i hartuar dhe miratuar | 2026 | 2026 | 150,000 leke/Donator I pambuluar | Drejtoria e Çështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë | OF |
| | Aktiviteti 2.2.2 Trajnimi i stafit të shërbimeve sociale dhe partnerëve lokalë (Policia, Shëndetësia, OJF-të) për zbatimin e protokollit dhe menaxhimin e rasteve emergjente në kohë reale. | Numri i trajnimeve të realizuara për zbatimin e protokollit (target: të paktën 2 trajnime).<br><br>Numri i stafit të shërbimeve sociale dhe partnerëve lokalë të trajnuar (target: 30 pjesëmarrës). | | | 30,000 Lek/Donator I pambuluar | Drejtoria e Çështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë | OF |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Aktiviteti 2.2.3 Krijimi i një rrjeti bashkëpunimi dhe koordinimi mes njësive administrative, institucioneve vendore dhe OJF-ve për menaxhimin efektiv të emergjencave | Numri i marrëveshjeve ose memorandumeve të bashkëpunimit të nënshkruara me OJF-të dhe institucionet partnere (target: 3 marrëveshje). | 2026 | 2028 | Pa kosto | Drejtoria e Çështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë | OF |
| | 2.3.1 Hartimi i programit të integruar për mbështetje psikosociale, duke përcaktuar objektivat, grupet përfituese (fëmijët në rrezik, PAK, të moshuarit e izoluar) dhe metodologjinë e ndërhyrjes | Dokumenti i programit të integruar të mbështetjes psikosociale i hartuar dhe miratuar . | 2025 | 2026 | 30,000 Lek/Donator I pambuluar | Drejtoria e Çështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë | OF |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 2.3.2 Formimi dhe trajnimi i ekipit multidisiplinar (punonjës socialë, psikologë, infermierë) për ofrimin e mbështetjes psikosociale në terren | Numri i sesioneve të trajnimit të realizuara: minimumi 2 trajnime në vit.<br>Numri i specialistëve të trajnuar për ofrimin e mbështetjes psikosociale: të paktën 6 persona (punonjës socialë, psikologë, infermierë). | 2026 | 2026 | 30,000 Lek/Donator I pambuluar | Drejtoria e Çështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë | OF |
| | 2.4.1 Ideimi dhe zhvillimi i platformës elektronike për menaxhimin dhe ndjekjen e rasteve, duke përfshirë specifikimet teknike, zhvillimin softuerik, testimin dhe përshtatjen sipas nevojave të bashkisë | Platforma elektronike e zhvilluar, testuar dhe funksionale: brenda vitit të dytë të planit. | 2025 | 2026 | 150,000 Lek/Donator I pambuluar | Drejtoria e Çështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë | OF |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 2.4.2 Trajnimi i stafit të njësisë lëvizëse dhe strukturave përkatëse për përdorimin efektiv të platformës dhe për mbledhjen e të dhënave në terren | 3 dite trajnim per perdorimin e platformes elektronike<br><br>Numri i stafit të trajnuar për përdorimin e platformës: të paktën 10 punonjës. | 2026 | 2026 | 45,000 leke/Donator I pambuluar | Drejtoria e Çështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë | OF |
| | 2.4.3 Implementimi i platformës dhe integrimi i saj me sistemet ekzistuese të shërbimeve sociale të bashkisë. | Numri i rasteve të regjistruara dhe të ndjekura në sistem çdo vit: minimumi 100 raste.<br>Raporti vjetor mbi funksionimin dhe efektivitetin e platformës: i përgatitur dhe i prezantuar çdo vit. | 2026 | 2028 | N/A | Drejtoria e Çështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë | OF |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Masa 2.5:** Krijimi i qendrës multifunksionale omunitare për familjet dhe grupet në Nevojë | 2.5.1 Hartimi i konceptit dhe planit të zhvillimit për Qendrën Multifunksionale Komunitare, duke përfshirë objektivat, shërbimet që do të ofrohen dhe grupet përfituese (familjet në nevojë, fëmijët, PAK, të moshuarit, viktimat e dhunës). | Është ndërtuar koncepti për Qendrën Multifunksionale Komunitare | 2026 | 2026 | N/A | Drejtoria e Çështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë | OF |
| | 2.5.2 Identifikimi dhe sigurimi i hapësirës fizike për qendrën, përmes ristrukturimit të një objekti ekzistues ose ndërtimit të ri | Është identifikuar hapësira fizike për qendrën dhe është funksionale | 2026 | 2027 | 200,000,000 Leke/Donator i pambuluar | Drejtoria e Çështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë | OF |
| | 2.5.3 Pajisja e qendrës me infrastrukturën dhe logjistikën e nevojshme (mobilim, pajisje teknologjike, materiale edukative dhe rekreative). | | 2027 | 2028 | 3,000,000 Leke/Donator i pambuluar | Drejtoria e Çështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë | OF |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 2.5.4 Vendosja në funksion të qendrës multifunksionale dhe ofrimi i shërbimeve sociale për familjet dhe grupet në nevojë | Qendra multifunksionale është ngritur dhe ofron shërbime sociale të integruara për komunitetin | 2028 | 2028 | 5,000,000 Leke/Donator i pambuluar | Drejtoria e Çështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë | OF |

Objektivi Specifik 3 Të zhvillohen fushata të vazhdueshme ndërgjegjësuese dhe edukative për të reduktuar stigmatizimin dhe për të promovuar pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në mbrojtjen sociale

| Objektivi | | Indikatori | Afati i zbatimit | | Buxheti dhe burimi financimit | Institucionet përgjegjëse | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | |
| Objektivi specifik 3: Të zhvillohen fushata të vazhdueshme ndërgjegjësuese dhe edukative për të reduktuar stigmatizimin dhe për të promovuar pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në mbrojtjen sociale | | | | | | | |
| | 3.1.1 Hartimi i planit vjetor të fushatave ndërgjegjësuese, me temat prioritare dhe grupet target. | 3 plane vjetore te fushatave ndergjegjesuese te hartuara | 2026 | 2028 | 94,788 ALL/Bashkia me fondet e veta | Drejtoria e Çështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë | OF |
| | | Numri i fushatave të realizuara në vit: të paktën 4 fushata/vit ( një për fëmijët, një për AK, një për dhunën dhe një për moshën e tretë). | | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | promovimin e respektit për diversitetin | Numri i qytetarëve të arritur nga fushatat: minimumi 400 persona në total/vit. | | | Donator I pambuluar | | |
| | 3.1.3 Realizimi i aktiviteteve komunitare dhe fushatave në terren (evente, ditë sensibilizimi, aktivitete sportive dhe kulturore me mesazhe sociale). | Numri i aktiviteteve edukative të realizuara: të paktën 4 aktivitete/vit x 3.5 vite ( workshope, aktivitete komunitare për gruan, aktivitetet komunitare per fëmijët, aktivitete komunitare për AK dhe moshën e tretë). | 2026 | 2028 | 400,000 ALL Bashkia me Fondet e veta 1,000,000 ALL/Donator I pambuluar | Drejtoria e Çështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë | OF |
| | 3.1.4 Përgatitja dhe shpërndarja e materialeve informuese dhe edukative (broshura, postera, spote sensibilizuese në rrjete sociale). | Numri i materialeve informuese të shpërndara: minimumi 1000 fletepalosjei/vit x 3.5 vite | 2026 | 2028 | 105,000 ALL Bashkia me fondet e vata | Drejtoria e Çështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë | OF |
| | | | | | | | |

## V. MONITORIMI DHE VLERËSIMI

Monitorimi dhe vlerësimi i Planit Social Vendor 2025–2028 për Bashkinë Himarë përbën një komponent kyç për të siguruar që qëllimet strategjike, objektivat specifike dhe masat e parashikuara të realizohen në mënyrë efektive dhe në përputhje me nevojat e komunitetit. Ky proces do të mundësojë një vlerësim të vazhdueshëm të progresit, identifikimin e sfidave dhe përcaktimin e ndërhyrjeve korrigjuese, duke garantuar një qasje dinamike dhe të orientuar drejt rezultateve.

Për këtë qëllim, Bashkia Himarë do të ndërtojë një mekanizëm gjithëpërfshirës monitorimi dhe vlerësimi, të koordinuar nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale në bashkëpunim me sektorët dhe specialistët përgjegjës, si dhe me aktorët lokalë dhe komunitetin. Ky mekanizëm do të ketë në fokus:

- Hartimin e një plani vjetor monitorimi që përfshin treguesit kryesorë të performancës për secilin objektiv, masë dhe aktivitet.
- Zhvillimin e një sistemi të rregullt raportimi me raporte gjashtëmujore dhe vjetore mbi ecurinë e zbatimit të planit.
- Përdorimin e treguesve të matshëm dhe të qartë, si numri i përfituesve, shtrirja gjeografike e shërbimeve, niveli i kënaqësisë së komunitetit dhe efektet në përmirësimin e cilësisë së jetës së grupeve në nevojë.
- Krijimin e një strukture vlerësimi që përfshin përfaqësues të bashkisë, shërbimeve sociale, OJF-ve dhe anëtarë të komunitetit për të garantuar një proces transparent dhe gjithëpërfshirës.

Përfshirja e komunitetit në procesin e monitorimit dhe vlerësimit do të jetë një element kyç, përmes konsultimeve periodike, grupeve të fokusit dhe sondazheve mbi kënaqësinë e përfituesve. Kjo do të ndihmojë në mbledhjen e feedback-ut të drejtpërdrejtë dhe në përshtatjen e shërbimeve me nevojat reale.

Rezultatet e procesit të monitorimit dhe vlerësimit do të prezantohen para Këshillit Bashkiak dhe do të publikohen për komunitetin, duke siguruar transparencë dhe llogaridhënie. Këto rezultate do të përdoren gjithashtu për rishikimin dhe përditësimin e planit, duke garantuar që ndërhyrjet të mbeten të përshtatshme dhe efektive.

**Drejtoria e çështjeve sociale, arsimit dhe e rinisë**

Aida Halilaj

**Drejtoria juridike**

Ardit Muhametaj

**Drejtoria e financës dhe planifikimit të buxhetit**

Laert Mezani